



PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

“IMPIANT PRODHIMI BETONI”

E&E NDERTIM sh.p.k

Permbajtja

1. Hyrje

1.1 Te pergjithshme

2. Pershkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional

3. Pershkrim i mjedisit te rajonit

3.1 Pozita gjeografike

3.2 Klima

3.3 Arkeologjia

3.4 Burimet ujore

3.5 Flora dhe fauna

4. Pershkrimi i aktivitetit

4.1 Profili i propozuesit

4.2 Informacion per qendrat e banuara (distanca nga qendra e banuar dhe njesia e qeverisjes vendore qe administroin territorin ku zhvillohet projekti)

4.3 Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/prpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit)

5. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis lidhur me aktivitetin

5.1 Ndikimet ne popullsi

5.2 Ndikimet ne klime

5.3 Ndikimet nga zhurmat

5.4 Ndikimet ne toke

5.5 Ndikimet ne ajer

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

5.7 Ndikime ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe transportit

5.8 Ndikimet mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike

5.9 Ndikimet me natyre nderkufitare

5.10 Ndikimet ne ujera

1. HYRJE

1.1 Te pergjithshme

Subjekti **E&E NDERTIM Sh.p.k** eshte rregjistruar prane QKB-se me numer NIPT-ti **K38707085U** Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte **DURRES; Spitalle, Durres, pasuria nr.69/13, zona kadastrale 8517, vol.4, faqe.40** Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje, toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Impiant prodhimi betoni”

Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legjislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Kjo eshte arritur duke:

- Dhene gjendjen reale nga pikepamja e ndikimit te ketij aktiviteti ne mjedisin human.
- Analizuar faktoret pozitive dhe negative mjedisor.
- Dhene rekomandimet per masat zbutese dhe minimizimin e ndikimeve negative ne mjedis.

Per kete eshte:

- Shfrytezuar informacioni baze i zones.
- Shfrytezuar dokumentacioni juridik dhe teknik i subjektit.

2. PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Disa nga ligjet, aktet ligjore e nenligjore mbi te cilat mbeshtetet hartimi i ketij dokumenti, paraqiten si me poshte:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 ‘ Per Mbrojtjen e Mjedisit ’*
- *Ligji Nr16/2014 “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis“*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 ‘ Per Lejet e Mjedisit’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ‘Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes’.*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 ‘Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore’*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 ‘Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 ‘Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.’*
- *Udhezim per dokumentacionin e duhur per “Leje Mjedisore”*
- *Urdhëri Nr. 321 datë 11.02.2014 “Për Lejet Mjedisore”0*

3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1 Pozita gjeografike.

Rrethi I Durrësit ndodhet ndërmjet 41° e 36' deri 41° e 15' gjerësi gjeografike veriore dhe 19° e 15' deri 19° e 38' gjerësi gjeografike lindore. Ai shtrihet nga kepi I Rodonit në veriperëndim deri tek Prroi I Agait pas shkëmbit të Kavajës në jugperëndim me një sipërfaqe 430km² dhe me një lartësi mesatare mbi nivelin e detit 2-6 metra. Vete qyteti I Durrësit zë pjesën perëndimore të rrethit të Durrësit midis koordinatave 41° e 18' e 40'' gjerësi gjeografike veriore deri në 19° e 26' e 21'' gjatësi gjeografike lindore me sipërfaqe 1,626 ha. Gjatesia e përgjithshme e vijës kufitare është 121.3km. Nga këta 52.4 janë kufij tokësorë, 61.8 kufij detarë, 7.1 janë kufij lumorë. Në pjesën perëndimore Durrësi laget në detin Adriatik, duke pasur një vijë bregdetare të thyer. Kufijet tokësorë janë me rrethinë e Tiranës dhe Krujës në lindje dhe verilindje dhe me rrethinë e Kavajës në jug dhe juglindje. Durrësi ka pozitë të favorshme gjeografike. Durrësi ndodhet në kryqëzimin e rrugëve të mëdha tregtare. Nder rruget kryesore janë: Durrës-Oher-Manastir-Sofje-Stamboll; Durrës-Elbasan-Korçë-Follorinë-Selanik. Durrësi ka rëndësi të madhe strategjike.

3.2 Klima

Klima e rajonit është mesdhetare me karakteristikat klimaterike të rajonit të Shqipërisë qendrore. Klima e rajonit është mesdhetare me karakteristikat klimaterike të rajonit të Shqipërisë qendrore. Temperatura mesatare vjetore e ajrit luhet rreth 15 - 16 -18° C, i njëjti nivel temperaturash është prezent gjatë gjithë vitit, me kulme të temperaturave të larta në muajt Korrik dhe Gusht me vlerë 29.3°C si dhe me temperaturat më të ulta që vërejtohen gjatë muajit Janar ku temperatura mesatare është 7.3° c. Temperatura mesatare vjetore e ajrit luhet rreth 15.20 C, i njëjti nivel temperaturash është prezente gjatë gjithë vitit, me kulme të temperaturave të larta në muajt Korrik dhe Gusht me vlerë 29.3 oC si dhe me temperaturat më të ulta që vërejtohen gjatë muajit Janar në të cilin temperaturat mesatare është 7.3oC. Lagështia mesatare relative e ajrit : Durrësi si një zonë bregdetare karakterizohet, nga një lagështi relativisht e lartë, me vlerë mesatare vjetore 70%, Reshjet atmosferike : Një element tjetër më i rëndësishëm i karakteristikave klimatike në këtë rajon janë reshjet atmosferike. Sasia e reshjeve mesatare vjetore luhet rreth 1000 mm. Muaji më i lagësht është muaji Nëntor dhe muaji më i thatë i vitit është korriku.

3.3 Arkeologjia. Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike.

Zona ku ndodhet objekti dallohet për objekte të veçanta arkitektonike e historike si dhe gjetje arkeologjike. Sipas studimit gjeologjik karakteristikat gjeomorfologjike e arkitektonike janë të zakonshme, e deri sot nuk përfaqësojnë ndonjë objekt të veçantë për t'u marrë në mbrojtje ligjore.

Durrësi mund të krahasohet me qytetet më të mëdha të Mesdheut të lashtë dhe mesjetar. Qyteti Dyrrah u ndërtua nga Ilirët Taulantë, dallëndyshasit në shekujt XIII-XI p.K. Banorët e parë të Dyrrahut, para ilirëve të quajtur protoilir, pellazgë, ngritën në rrethinat e këtij qyteti,

vendbanimet e para parahistorike. Në kushtet e një klime mesdhetare, vendi më i përshtatshëm për banim ishte ajo e lumit Erzen (Ululeus) si dhe Ultësira Perëndimore përreth saj. Në bregdetin e Gjirit të Durrësit u vendos qëndra e parë apo limani me emrin Dyrrah. Sipas autorëve të lashtë, ky qytet u themelua nga dy mbretër me origjinë ilire të quajtur Dyrrah dhe Epidamn. Ai kishte edhe punishte të punimit të qeramikës, të metaleve, të pëlhurave të lëkurës, kantier për ndërtimin e anijeve etj. Dëshmi e zhvillimit të tregtisë janë monedhat prej bronzi e argjendi që janë prerë në Dyrrah. Ndërsa për lulëzimin urban dëshmon mozaiku i një dyshemeje, i quajtur Bukuroshja e Durrësit. Nga shekulli I-III e.s. qyteti i Dyrrahut përjetoi një periudhë lulëzimi, u bë qëndër dhe porti kryesor i brigjeve të Adriatikut lindor.

Konstruksioni i këtij objekti krijon vlera për vet objektin në përgjithësi, por kjo nuk është e mjaftueshme. Për këtë investitori ka marrë të gjitha masat për të krijuar një pamje sa më të këndëshme për syrin e njeriut, duke mbjellur drurë dekorativë, e duke sistemuar në mënyrë të këndëshme të gjitha hapsirat e boshe që mund të krijohen. Në këtë hapsirë është parashikuar sistemim me sipërfaqe të gjelbert.

3.4 Burimet ujore Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet një situatë e ndryshme nga stacioni në stacion për sa i përket të gjithë treguesve të cilësisë së ujrave. Për 3 stacionet e lumit Ishëm vlera e O të tretur paraqitet e moderuar e klasifikohet e cilësisë së tretë. Tre stacionet e lumit Erzen rezultojnë të pasura me oksigjen dhe klasifikohet të cilësisë së parë, ku vëcojmë stacionin referencë me përmbajtje me të lartë 9.53mg/l.

Ndërsa për sa i përket përmajtjes së NBO si dhe e NKO për Ishmin gjendja paraqitet problematike duke e kaluar nivelin e cilësisë së keqe (klasa e pestë). Situata paraqitet problematike edhe për përmajtjen e NO₂ e NO₃.

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet një situatë e ndryshme nga stacioni në stacion për sa i përket të gjithë treguesve të cilësisë së ujrave. Për 3 stacionet e lumit Ishëm vlera e O të tretur paraqitet e moderuar e klasifikohet e cilësisë së tretë. Tre stacionet e lumit Erzen rezultojnë të pasura me oksigjen dhe klasifikohet të cilësisë së parë, ku vëcojmë stacionin referencë me përmbajtje me të lartë 9.53mg/l.

Ndërsa për sa i përket përmajtjes së NBO si dhe e NKO për Ishmin gjendja paraqitet problematike duke e kaluar nivelin e cilësisë së keqe (klasa e pestë). Situata paraqitet problematike edhe për përmajtjen e NO₂ e NO₃.

Shkaqet për këtë gjëndje janë shkarkimet e lengeta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve të zonës së autostradës.

Ujërat e cilësisë së ulët në të keqe paraiten edhe për përmajtjen mesatë të fororit (ujërat e lumit të Tiranës dhe të Lanes që shkarkojnë në Ishëm).

Vlera me të lartë të përmbajtjes së amonjakut NH₄ paraqitet në lumin e Lanes tek Ish dogana që ndodhet pas shkarkimit të kolektoreve të ujrave urbane, të cilat janë përgjegjëse direkte për këto vlera. Po kështu paraqitet situatë edhe për lumen Erzen në stacionet e fundit.

PERMBLEDHJE JO - TEKNIKE
E&E NDERTIM Sh.p.k
Impiant prodhimi betoni

Sipas Raportit për Gjendjen e Mjedisit ne R.SH. (2014) rezulton Ujrat e lumejve vleresohen alkaline me pH nga 7 -8.3. Lumi i Ishmit dhe Erzen vleresohen me percjellshmeri të lartë elektrike që tregon ndikimin e vazhdueshëm të shkarkimeve urbane e industriale dhe lumi I Ishmit është kritik dhe përse I përket përmbajtje NBO, P, që tregon prezencën e fuqishme të ndotjeve urbane dhe industriale. Kjo vërehet dhe nga përmbajtja e lartë e amonjakut nga shkarkimet e ujrave urbane të patrajuara e industriale të lumit të Tiranës dhe të Lanës. Lumi I Ishmit mbetet lumi më i ndotur në Shqipëri.

Nga monitorimi i ujrave bregdetare është problematike sidomos ne Portoromano ku behen shkarkime urbane te patrajuara. Kjo situatë do te permiresohet me venien ne kapacitet te plote te impiantit te trajtimit te ujerave urbane. Gjate vijes bregdetare ne Durres ka mjaft kanale e rrjedha te ndryshme qe derdhen ne det duke sjelle ndotjen e ujerave bregdetare e u bere rrezik potencial per pushuesit ne sezonin e veres.

Ujrat nëntokësore janë pasuria me rendesi jetike për popullatën dhe janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm me intensitet të lartë rritje dhe rrisht të përhershëm ndotje nga veprimtaritë natyrore e njerzore. Për ket arsye mere rëndësi të veçantë monitorimi i tyre. Në basenin e Erzen - Ishëm monitorohet akuiferi ujëmbajtës i zhavoreve të Kuaternarit të Tiranës me një rrjet monitorimi me 5 shpime dhe akuiferi ujëmbajtës i zhavoreve të Fushe - Krujës me 4 shpime. Për vitin 2014 rezulton koeficienti vjetor i shfrytëzimit në Tiranë $K = 0,85 - 0,95$

Ndersa temperatura mesatare e ujit ka rezultuar $17,21^{\circ}\text{Celsius}$ (norma 8 - 15, deri 20) ndersa vlera mesatare e pH për vitet 2010 - 2014 ka variuar 7.18 - 7.35. Vlerat mesatare të fortësisë së përgjithshme kanë variuar për vitet 2010 - 2014 në $19,37 - 25,42^{\circ}\text{gjermane}$.

Mineralizimi i përgjithshëm mesatar për vitet 2010 - 2014 varion $Mp = 621,8 - 866,67 \text{ mg/l}$. Uji është i tipit hidrokarbonat - kalcium- magnezi. Përmbajtja mesatare e Na për vitet 2010 - 2014 varion $25,99 - 77,8 \text{ mg/l}$ ndersa Mbetja thatë mesatare varion $419-534,5 \text{ mg/l}$. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion $105,44 - 132,27 \text{ mg/l}$. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion $19,26 - 34,1 \text{ mg/l}$ dhe e Fe $0,04 - 0,06 \text{ mg/l}$.

Po kështu, Përmbajtja mesatare e Cl për vitet 2010 -2014 varion $25,64 - 62,76 \text{ mg/l}$, e sulfatëve (SO_4) varion $49,03 - 95,73 \text{ mg/l}$, e nitrateve (NO_3) $11,11 - 23,47 \text{ mg/l}$ dhe e nitriteve (NO_2) është në sasinë nën $0,01 \text{ mg/l}$ deri në $0,01 \text{ mg/l}$.


Zona ku shtrihet qyteti i Durrësit është e pasur me ujëra nëntokësore në nivelit të ceket që rrit në këtë mënyre vulnerabilitetin për t'u ndotur. Shtresezimet ujëmbajtëse ushqehen nga ujrat e lumit Ishëm dhe Erzen. Këto ujëra janë të pijshëm dhe kanë pH prej 7 deri 9. Sipas specialisteve, këto ujëra rrezikojnë të ndoten nga prania në zonën e kënetës të vendgrumbullimit të mbetjeve, nga ndotja e mëparshme e mjedisit dhe tokës në zonën e lindanit dhe të bikromateve, nga ish fabrika e prodhimit të kimikateve me bazë sulfur.

Nga monitorimet e kryera për zonënt rezulton se përqendrimi i lindanit në zonë zvogëlohet shumë qoftë në drejtim horizontal ashtu edhe në drejtim vertical, p.sh në thellësi 20 cm përqendrimi i lindanit është rreth 4 herë më i madh se në thellësinë 80 cm duke bërë që të mendohet se në thellësi 5-6 m sasia e tij zvogëlohet në përqendrime të pallogaritshme. Gjithashtu edhe ndërtimi i parkut energjetik në zonën e Porto Romanos krijon një rrezik edhe për ndotjen e ujërave nëntokësore.

PERMBLEDHJE JO - TEKNIKE
E&E NDERTIM Sh.p.k
 Impiant prodhimi betoni

Është i njohur fakti se burimet kryesore të ndotjes janë dhe mbetjet urbane (mbetje inerte dhe të lëngshme). Ndotja e ujit urban ndodh nga prania e P (fosforit) që e ka burimin nga detergjente të ndryshëm që përdoren kryesisht prej familjeve. Nitratat (Azotet) janë një tjetër element ndotës i gjendur në ujë, në formën e NO₂ dhe NO₃, që vjen prej aktiviteteve urbane, bujqësore dhe industriale. Ndotja më e madhe e ujit është ndotja mikrobiologjike që shkaktohet nga ujërat e zeza dhe që përfundojnë pa trajtimin e tyre, në lumenj dhe në forma të tjera në anë të rrugëve dhe kanalet natyrore të drenazhimit dhe përfundimisht derdhja e tyre në det.

Harta Hidrogeologjike



3.5 Flora dhe fauna

- *Ekosistemet, habitatet*

Per efekt prezantimi sa me efektiv kemi bere nje nendarje ne grupe te flores.

- *Flora natyrale – Bime tokesore*

a) Zonat me pyje

Kjo zone eshte shume e pasur me flore natyrale si peme, shkurre dhe vegjitacion tokesore. Pyjet shtrihen ne nje zone te konsiderueshme kryesisht ne kodra. Ne keto pyje gjenden specie te ndryshme pemesh, peme gjethegjere te familjes Fagaceae, te tilla si *Quercus coccifera*, *Quercus robur*, *Quercus trojana* etj. Nga familja Ulmaceae gjenden *Ulmus campestris*. Ne kete zone ka gjithashtu peme te familjes Salicaceae, kryesisht *Salix alba* dhe *Populus alba*.

Te nje rendesie te vecante jane pyjet konifere perfaqesuar nga Familja Pinaceae me speciet *Pinus pinea* dhe *Pinus halepensis*. Ne katin e dyte te pyllit gjenden shkurret e pyllit te familjes Ericaceae, familja Rozacea perfaqesohet nga Rozacamina etj.

b) Zona me shkurre

Ne pyje dhe prane zonave me shkurre jane *Cistus salvifolius* dhe *Thymus capitata*. Perfaqesues nga familja Anacardiaceae jane *Tistecia terelintus* dhe *Pistacia lenticus*. Kategoria e trete e bimeve natyrale jane vegjetacioni i tokes ose bimet e egra. Ato rriten nen druret pyjore, ullinjte, ne ane te rrugeve, ne kanale, ne fshate dhe ne qytet, gjithashtu gjenden edhe ne toka te kultivuara se bashku me drithrat, duhanin, perimet dhe kulturat e tjera bujqesore. Duhet te theksohet se ato rriten me mire sidomos ne parcela te pa kultivuara.

Nen ullinjte dhe peme te tjera gjenden :

- *Inula viscosa*
- *Centaureasolstitialis*
- *Xanthium strumarium*
- *Chicoriumintybus* i families Camposampoticaea
- *Ammivisnaga* dhe *Daucus carota* (familia Umbeliferae)
- *Cynodon Daktylon*
- *Anthoxanthum adorathum* (Gramunacea)
- *Salvia hormine* dhe *phlomis fruiticosae* (Labiatae) Specie qe shoqerohen me kulturat bujqesore:

- *Cynodon daktylon*
- *Sorghum halepens*
- *Avena fortuna*
- *Lolium perense phalaris arundinaceae*
- *Abutilon theofrasi*
- *Solonum nigrum*
- *Vicea Lutea*, *V. Sativa*, *V. Villosa*

Vegjetacioni ne zonat urbane dhe ne ane te rrugeve:

Pervec kulturave bujqesore ka specie te cilat rriten ne fshatrat e rajonit te Fush-krujes, prane gardheve, ne kopesht, ne ane te rruges. Speciet kryesore jane:

- Graminoza (*Cynodon dactylon*)
- Leguminosaeae (*Trifolium sponois spinosa*)
- Malvaceae (*Malva silvetris*)
- Poligonaceae (*Poligoneumavikulare*)
- Etj.

4. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

4.1 Profili i propozuesit


Subjekti E&E NDERTIM Sh.p.k kryen aktivitetin "Impiant prodhimi betoni", eshte regjistruar ne QKR me **Forme Ligjore si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar Sh.p.k**, i pajisur me nr. Identifikim NIPT: **K38707085U**, me Administrator **Z Lorenzo Këllici**.

Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij ne **DURRES; Spitalle, Durres, pasuria nr.69/13, zona kadastrale 8517, vol.4, faqe.40**.

Aktiviteti qe ushtrohet si impiant i prodhimit te betonit eshte instaluar ne nje siperfaqe te konsiderueshme. Numri i njerezve qe punojne eshte rreth 8 punonjes .

Pra me kete **Permbledhje Joteknike** jepet informacion per projektin qe eshte realizuar, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga investitori per zbatimin e kriterëve per mbrojtjen e menaxhimin e qendrueshem te mjedisit, ne territorin e objektit.

Qarku Durrës
organizimi administrativ



4.2 Informacion per qendrat e banuara (distanca nga qendrat e banuara dhe njesia e qeverisjes vendore qe administron territorin ku zhvillohet projekti)

Vendi i zhvillimit te aktivitetit ndodhet ne **DURRES; Spitalle, Durres, pasuria nr.69/13, zona kadastrale 8517, vol.4, faqe.40;**, ne ane te rruges ne nje distance te konsiderueshme nga aktivitetet e tjera perreth apo zonat e banuara Mund te themi se zhvillimi i punes se ketij subjekti nuk perben ndikim negativ per mjedisin apo banoret pasi nuk kryhet aktivitet me clirime te demshme gazesh apo shkarkimesh te tjera te rrezikshme e me natyre ndotjeje.

Perkundrazi, vendosja e saj ne kete zone sjell vetem ndikime pozitive sepse jane punesuar nje numer i konsiderueshem i banoreve perreth (te nevojshem per plotesimin e fuqise punetore qe i duhet aktivitetit), duke rritur keshtu mireqenien e tyre ekonomike. E gjithë zona karakterizohet nga shtresa te holla toke me depertueshmeri te larte. Nuk ka objekte te mbrojtura gjeologjike, apo zona me interes gjeologjik. Mundesia e lekundjeve te theksuara sizmike eshte e ulet, pra ndertimi i ketij objekti ne kete territor eshte studiuar duke arritur ne perfundimin se ky eshte nje pozicion i favorshem strategjik. Bimesia natyrore e zones perbehet nga shkurre te profilit te ulet dhe bari vendas.

4.3 Pershkrimi i proceseve ndertimore dhe teknologjike (kapacitetet prodhuese/perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit)

➤ **Lendet e para, lendet ndihmese, produkte te ndermjetme dhe produkti perfundimtar**

Per prodhimin e betonit perdoren si lende e pare dhe lende ndihmese:

- rere e gurit;
- granil ;
- cemento
- uje
- inerte guri te fraksionuara

Produkte perfundimtare te perftuara pas kryerjes se procesit teknologjik jane:

- betoni i markave te ndryshme

Magazinimi i lëndëve të para.

Agregatet depozitohen dhe magazinohen në venddepozitime të ndara, ku sheshi është i mirë sisistemuar, i betonuar si dhe i rrethuar pranë zonës së instalimeve të nyjes së betonit.

Peshimi i materialeve (agregateve).

Për të prodhuar beton të gatshëm, agregatet transferohen nga vend-magazinimi dhe peshohen në sasi të saktë, të përcaktuara si nga specialistet përkatës.

Peshimi i ujit dhe materialeve shtesë/ndihmese.

Uji dhe aditivët peshohen sipas markës së betonit. Uji është elementi që realizon miksimin e tyre me njera-tjetrën duke reaguuar kimikisht me çimenton dhe shtesat e tjera. Shtesat shtohen sipas markës përkatëse të betonit.

Çimento.

Çimentoja transferohet për në nyjen e betonit me kamionët me çisternë të posatshe, ku ajo ruhet në sillosa. Çimento është materiali më i rëndësishëm për procesin e prodhimit të betonit. Hidratimi i çimentos, reaksioni kimik midis çimentos dhe ujit, ndikojnë në ngurtësimin e betonit. Raporti Uji dhe çimento përcaktojnë tipin e betonit si një element tepër i rëndësishëm, si vetite e saj kryesore fortësia dhe çëndrueshmëri. Në varësi të markës së kerkuar, sasinë e saktë të çimentos peshohet dhe shtohet në njesinë e perzierjes për perzierjen së bashku me agregatet e tjera, ujin dhe aditivët.

Përzierja e lëndëve të para.

Në procesin e prodhimit të betonit, koha e përzierjes së lëndëve të para është shumë specifike, në mënyrë që të marrë një masë homogjene me agregatët, çimenton, ujin dhe aditivët.

Transporti drejt konsumatorit (firmat e ndërtimit).

Betoni i gatshëm sipas kërkesës së konsumatorit transferohet nga nyyja e betonit, për në objekt me anë të betonierave të cilët e përziejnë gjatë gjithë rrugës për në sheshin e ndërtimit në mënyrë që të jetë sa më homogjene dhe të mos ngurtësohet. Pra, linja kryesore e ndjekur në këte impant prodhimi betoni është:

Magazinimi → Prodhimi → Transportimi për përdorim.

➤ Proceset e prodhimit dhe mjetet e punës

Disa nga makinerite dhe pajisjet që përdoren gjatë kryerjes së proceseve të punës në këte instalim janë:

- Fadrome (Mjet ngarkimi-shkarkimi) dhe kamiona transporti
- Gjenerator
- Bunkerat/sillosat e lëndës së parë
- Vaska dekantimi
- Pajisje të komandimit automatik

Nuk janë analizuar zona të tjera, por është bërë përzgjedhja e kësaj zone nga investitori, kjo lidhet ngushtë dhe me faktin se vendi i ushtrimit të aktivitetit linjë e prodhimi betoni ka të gjitha kushtet e nevojshme pasi ndodhet në periferi të qytetit. Mbrapa varrezave të qytetit të Kavajës, jashtë vijës së verdhë. Gjithashtu zgjedhja e këtij sheshi si alternativë e vetme ka ardhur si rezultat i vetë zhvillimit të kësaj zone me situatën aktuale të saj. Trualli i zonës në fjalë është plotësuar me të gjitha ndërtimet e nevojshme për një instalim bashkëkohorë me parkim për mjetet e transportit dhe të ndërtimit siç janë betonierat, rrugë të brendshme si dhe ndarja nga rruga me breza të gjelbër. Aktiviteti ndodhet në një distancë të vogël nga rruga kryesore, shumë pranë saj.

Gjithashtu në funksion të zonës, lind një kërkesë më e lartë përsa i përket respektimit rigoroz të normativave të shfrytëzimit të sipërfaqes dhe distancave normative të përcaktuara nga "Rregullorja e Urbanistikës" si dhe transparencë, bashkëveprim dhe referencë në peizazhin e gjelbër. Në aspektin kompozicional zgjedhja është e bazuar në krijimin e hapësirave të proporcionuara, pa

PERMBLEDHJE JO - TEKNIKE
E&E NDERTIM Sh.p.k
Impiant prodhimi betoni

humbur logjikën urbanistike të pranishme në rrethinat e zonës së studiuar. Impianti është zgjedhur në mënyrë të tillë ku konsumi energjetike të jetë me efijencë energjetike.



Në këtë shesh ushtrohet aktiviteti i linjës së prodhimit të betonit me një kapacitet që nuk e kalon **300m³/ditë**. Ndërsa konsumi për ujë është zgjidhur me anë të një pusi shpimi që është bërë në këtë pronë për nevojat e kësaj linje të prodhimit të betonit. Impianti nyje-betoni është montuar në qëndër të sheshit ku prodhohet beton i gatshëm, treguar edhe ne figuren bashkengjitur:

Në këtë shesh do të depozitohen materialet e nevojshme inerte në përfundim të pronës ndërsa hyrja dhe dalja nga ky kantier do të jetë nga verilindja, një hyrje për automjete e rënda siç janë betonieret dhe e njëjta hyrje për lëvizjen e mjeteve të transportit, kamione ngarkues /shkarkues, që të dyja janë të pozicionuar nga rruga nacionale. Disa nga transportuesit/kamionet dhe mjetet e tjera të ngarkim-shkarkimit tregohen ne foto si ne figure.

Rrugët e projektuar përreth këtij objekti do të kenë një sens lëvizës (ku hyrja – dalja e makinave të transportit do të jenë nga lindja e objektit), në këtë mënyrë nuk do të bëhet burim aksidentesh për vetë qarkullimin e brendshëm të objektit, si dhe do të vihen tabela sinjalizuese rrugore përkatese. Në këtë objekt projektimi i zonave të parkimit është mbi tokë, ku parkimi i automjeteve të punonjësve do të jetë e përcaktuar ndërsa e betoniereve të lëvizshëm do të jetë nga përpara impiantit dhe në vendshkarkimin e impiantit. Mjedisi përreth është ndërtuar konform kushteve teknike, dhe kushteve të mbrojtjes kundra zjarrit ku në mjedisin përreth do të vendosen 2 depozita me kapacitet të nevojshëm për ujë.

Materialet inerte që do të përdoren për prodhimin e betonit sipas klasave të ndryshme do të jenë të cilësisë së lartë dhe konform kushteve të cilësisë për këto produkte. Inerti që do të përdoret është i larë dhe do të blihet nga firma të kontraktuar për të blerë këto produkte, do të lidhen kontrata vetëm me firma të cilët janë të pajisur me liçencë për shfrytëzim të karrierave për materialet e ndërtimit për këto agregate.

Nyja do të ketë dy sillosa me kapacitet 150 ton çimento, të magazinuara dhe të ajisura me peshore elektronike deri në 5 ton, dhe sistem tubacionesh, valvula, filtrash që realizojnë një hedhje të dozës në autobetone pa krijuar ndotje të ajrit nga pluhurat edhe pse niveli i ndotjes është minimal pasi inertet janë të lara.

Sistemi i drejtimit të impiantit ndodhet në një kabinë e cila është e gjitha elektronike me parametra evropiane. Impianti ka një kapacitet prodhimi teorik **50 m³ /orë**. Raporti për të prodhuar beton është 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndërsa ujë është raporti u/ç=0.6 pra për këtë impiant në bazë të kapaciteti mesatar që është 50m³/h, arrijmë në përfundimin së këtij impianti do të duhen rreth 24 ton çimento, 48 ton rërë, 96 ton çakull apo zall, ndërsa ujë rreth 14.5 m³ /h.

Në lidhje me ngarkimin dhe transportin është parashikuar që pajisjet do të përbëhen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje bëhet për shkak të adaptueshmërisë dhe fleksibilitetit të lartë që kanë këto lloj pajisje, shkallës së lartë të disponueshmërisë, si dhe mundësinë për të kombinuar ato për të realizuar punime të ndryshme sipas nevojave të prodhimit. Nevojat për ngarkim përcaktohen nga numri i kamionve të nevojshëm që varen nga distanca e transportimit, disponueshmëria për punë e makinave ngarkuese dhe e kamioneve, orët e punës në dispozicion për ditë/turn, etj.

Koha në dispozicion për ngarkim është 7 orë/turn ose ditë. Koha e nevojshme për një cikël të plotë të makinës ngarkuese për të ngarkuar materialin nga pingu me materiale në kamion është 60 minuta. Koeficienti i mbushjes së kovës së makinës ngarkuese zakonisht është 80%.



Për të pershkruar në mënyrë të përbledhur procesin teknologjik në linjen e prodhimit në impinatit e betonit mund të themi se si fillim materjali i thyer dhe i fraksionuar depozitohet në bunkerin/sillosat e lende se pare.


Lenda e pare e depozituar ne vendin e caktuar, ne bunkerin/sillosat e lendes se pare per te kaluar me pas ne pjesen tjeter te linjes se prodhimit.

Me pas, prej ketj dozohet ne menyre automatike se bashku me cimenton dhe transportohen per t'u perzjere edhe me uje dhe aditive te ndryshem per prodhimin e betonit ne perputhje me markat e betonit te kerkuara. Pas kesaj, nepermjet disa sitave vibruese, vibrohet per te patur cilesine dhe paraametrat e kerkuar.

Procesi i dozimit dhe transportimit shoqerohet me sperkatje me uje me qellim te evitimit te pluhurave ne mjedisin rrethues. Furnizimi me kete uje behet nepermjet sistemit te tubacioneve te zones, nga ku me pas shkon ne impjantin e prodhimit te betonit.

Prodhimi i betonit realizohet sipas skemës së më poshtme:





5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS LIDHUR ME AKTIVITETIN

Me poshte paraqitet nje analize e emetimeve ne mjedis qe mund te vijne nga ushtrimi i ketij aktiviteti. Per vete natyren e veprimtariseqe ushtron, subjekti i ka marre te gjitha masat per minimizimin e ndikimeve te mundshme negative ne komunitetin dhe mjedisin perreth duke realizuar mbrojtjen e te gjithë komponenteve mjedisore: te ujerave nentokesore e siperfaqesore, ajrit, tokes nga depozitimi i mbetjeve dhe mbrojtjes nga niveli i larte i zhurmave apo vibrimeve te betonit.

5.1 Ndikimet ne popullsi

Realizimi i aktivitetit nuk ka ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se ketij rajoni ku zbatohet aktiviteti. Gjate zhvillimit te aktivitetit jane marre te gjitha masat e nevojshme per reduktimin/minimizimin e emetimeve ne ajer, toke apo uje, te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo popullsisë se rajonit.

Ne zhvillimin e aktivitetit nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsinë e zones, te zhvendosjes se saj per shkak te tij. Ky aktivitet nuk ka ndikime negative ne shendetin mendor dhe fizik te popullsisë te ndodhur rreth vendit te ushtrimit te tij.

5.2 Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne drejtim te perkeqesimit te saj. Nuk ka ndryshime ne temperature ne drejtim te eres apo sasise se rreshjeve. Pra, mund te thuhet se kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

5.3 Ndikimet nga zhurmat

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkim- shkarkimit, kamionat e punes dhe sitat vibruese te betonit. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara per mjedise pune 8 ore , megjithate shoqeria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtese ndaj saj. Objekti eshte larg qendrave te banuara dhe punohet vetem ne nderresen e pare e ne keto rrethana intensiteti i zhurmave te krijuara prej linjes dhe mjeteve nuk perben problem shqetesues per zonen perreth.

5.4 Ndikimet ne toke

Ndotja e tokes mund te ndodhe si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit

te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem.

Sistemi i transportimit dhe ngarkim-shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali i granilit terhiqet vete nga sistemi i silloses se makinerise. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne toke. Automjetet dhe makinerite duhet te jene te kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik te Automjeteve. Mundesia e ndotjes nga rrjedhjet eshte pothuajse zero. Automjeteve duhet tu kryhet pastrimi ne menyre periodike per te mos mbartuar papasterti te tjera te grumbulluara gjate procesit teknologjik gjate transportit ne zonat urbane dhe me rruge te asfaltuara. Shkarkimi ne toke i elementeve te demshem per mjedisin, shkakton ndotje serioze ne mjedis, ndaj rekomandohet qe aktivitetet te jene te paisura me masa mbrojtese dhe te shtrojne siperfaqet ku ato veprojne.

Mbeturinat e ngurta vijne nga:

Aktiviteti human: mbetje urbane te plastikes, qelqit, metaleve etj te cilat jane te riciklueshme dhe do te hidhen ne kontenieret e mbetjeve urbane te zones.

Nga procesi teknologjik: vleresohet te kete mbetje te ngurta nga ambalazhet e produktit, si plastmas, leter, karton paleta druri. Persa i perkete materialit te demtuar, ai mund te rifutet ne procesin e prodhimit dhe te ripaketohet, ndersa ambalazhet e tyre, hidhen ne kontenieret e mbetjeve te ngurta te zones.

5.5 Ndikimet ne ajer

Ndotja e ajrit vjen nga pluhuri i granilit dhe reres te ekspozuara ne ambjente te hapura, si dhe nga aktiviteti i ngarkimit e shkarkimit te materialit. Procesi punes se impiantit perfshin procese te gjenerimit te pluhurave dhe per te minimizuar ndotjen e ajrit kryhet lagia dhe sperkatja here pas here me uje nga sitemi i tubacioneve te zones.

5.6 Ndikimet ne flore dhe faune

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te hapur dhe brenda siperfaqes se percaktuar per kete qellim keshtu qe nuk ka lidhje me mjedis tjetër, per rrjedhoje as derdhje te shkarkimeve apo mbeturinave qe mund te shkaktojne ndryshime ne floren e faunen e zones.

5.7 Ndikimet ne zhvillimin e rrugeve lokale dhe te transportit

Aktiviteti nuk ka ndikim ne rruget lokale dhe te transportit, madje subjekti eshte angazhuar ne mirembajtjen e tyre me qellim mbarevajtjen e zhvillimit te aktivitetit te tij pasi ne keto rrugekalojne kamionat e ngarkim-shkarkimit qe shoqeria "E&E Ndertim" Sh.p.k ka ne dispozicion.

5.8 Ndikimet mbi trashegimine arkeologjike, kulturore dhe historike

Aktiviteti qe ushtron subjekti "E&E Ndertim" Sh.p.k zbatohet ne nje zone ne siperfaqen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime lidhur me trashegimine arkitektonike dhe historike apo tiparet arkeologjike. Kjo tregon se zona eshte e lire per vazhdimin e ushtrimit te veprimtarise se ketij aktiviteti dhe njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

5.9 Ndikimet me natyre nderkufitare

Ky aktivitet nuk ka ndikime me natyre nderkufitare sepse ndodhet brenda territorit te Republikes se Shqiperise **DURRES; Spitalle, Durres, pasuria nr.69/13, zona kadastrale 8517, vol.4, faqe.40** dhe nuk ndodhet ne kufijte tokesore me shtetet e tjera qe kufizojne Shqiperine.

5.10. Ndikime ne ujera

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- b) Pastrimi i ambientit ne rast te shkarkimit te materialeve te lendes se pare nga avari te ndryshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te nderprerjeve te energjise elektrike.
- c) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e sheshit te shoqerise
- d) Ujerat e pastrimit te ambientit te parkimit te makinerive dhe paisjeve te renda.
- e) Ujerat e perdorur per pastrimin e sheshit ku depozitohet lenda e pare.
- f) Ujerat e perdorura per qellime sanitare.

Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete aktivitet, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla. Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne ujerat e pastrimit te ambientit te punes dhe mjeteve te transportit. Procesi teknologjik perfshin perdorimin e ujit, por nuk ka shkarkime. Ndikimi nuk eshte me efekt domethenes ne mjedisin e zones.

“E&E Ndertim” Sh.p.k

Administrator

Lorenzo Këllici



FORMULARI TIP I

Date: 29/07/2019

NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja", Kreu VI "Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B", pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"; Leje mjedisore Tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; EFE Nderim
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Spitolle DUKËS
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; Implant puvolim Betoni
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;
info@akm.go.al

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë
Lorenc Këlliqi



Nr.kontakti

0697487976